

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 180, Tetor 2018

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

U ZHVILLUA KONFERENCA E VI ZGJEDHORE E SHOQATËS ATDHETARE "DUKAGJINI" 2

PARAQITJA E REALIZIMEVE NGA KONFERENCA E V DERI NË KONFERENCËN E VI 3

- DOMOSDOSHMËRI E EMANCIPIMIT SHOQËRORE TË BASHKËSISË DUKAGJINASE -

...Vijmë në konferencën e VI me realizime jo të pakta. Ne, vijmë të ecim bazuar në shprehjen filozofike: "Mos shko aty ku të shpie shtegu, por shko atje ku nuk ka shteg dhe lë gjurmë!" Pra, ne e filluam punën në rrugë pa shteg, por e kishim të qartë misionin tonë. Ishin dukagjinasi intelektual, të ndërgjegjshëm për detyrën që i kishim vënë vetes. Prandaj ndjehemi krenar para bashkësisë dukagjinase dhe kudo shtrihet shoqata, para jush miq e mike, për arritjet në tërësi të Shoqatës, ...

PARAQITJA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE NË VITET 2014 - 2018

Të nderuar delegate, miq e të ftuar!

Në paraqitjen e punës së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" në këto pese vite, që bëri Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj, ndoshta ndonjëri dhe tha, se si është e mundur të arrihen gjithë këto realizime me një pune kaq vullnetare! Por, ja që janë arritur, fal një vullneti të pa ndalur, të një përkushtimi të jashtëzakonshëm të Kryesisë së Shoqatës para asnjë pengese qoftë objektive apo subjektive. Por, këto arritje nuk do të ishin të mundura pa një mbështetje financiare të dukagjinaseve kudo janë, të cilët po i paraqesim më poshtë:

Këto mundësime financiare po i ndajmë në dy grupe...

NJOFTIM! 7

- Në konferencën e VI të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në detyrën e Kryetarit të Saj, u rizgjedh zoti Ndue Sanaj;
- Këshilli i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i zgjedhur në Konferencën e VI të saj, me datën 21 tetor 2018, përbëhet:
- Këshilli i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në mbledhjen e tij, me datën 25 tetor 2018, zgjodhi strukturën drejtuese të saj:
- Këshilli i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në mbledhjen e tij, me datën 25 tetor 2018, miratoj përbërjen e Kryesisë së Shoqatës dhe anetarët e saj:

Kryesia e Shoqatës

Sëmundja e Parkinson-it 9

Ka marrë këtë emër për nder të kirurgut Anglez James Parkinson, që përshkoi për herë të parë në vitin 1817, si paraliza agjituse, sëmundja kronike (e zgjatur), që prekte në radhë të parë personat 60-70 vjeçar, pra në dekadën e 6-7 të jetës. Sot vlerësohet si sëmundje neuro-degjenerative e sistemit nervor extra-pyramidal dhe klasifikohet në "çrregullimet lëvizore". Incidenca mesatare e sëmundjes është mesatarisht 20 raste të reja për 100.000 banor në vit, me një kulmim (pik) të saj në moshat 70-75 vjeç, por që në moshën 80 vjeç arrin në 130 raste në vit për 100.000 banor. Në Francë llogariten 150.000 persona të prekur nga Parkinsoni. Llogaritet si sëmundja e dytë neuro-degjenerative, pas sëmundjes Alzheimer. Ajo prek 1% të mbi 60 vjeçarve dhe 4% të mbi 80 vjeçarve...



U ZHVILLUA KONFERENCA E VI ZGJEDHORE E SHOQATËS ATDHETARE “DUKAGJINI”

Me datën 21 tetor 2018, dite e Diele, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi”, në Shkodër, u mbledhe Konferenca e VI e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me pjesëmarrjen e delegatëve që përfaqësonin degën e Shkodrës, Tiranës, Malësisë së Madhe, Lezhës e Kurbinit.

Në Konferencë morën pjesë një grup përfaqësues të Shoqatës së vëllazërisë Kosove – Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, me Kryetarin e saj, z. Ukshin Jashari; përfaqësues të Shoqatës Atdhetare “Malësia e Madhe”, zoti Ilmi Kurti, Alfred Haxhari; përfaqësues i Shoqatës “Dukagjini”, në Miçigan, zoti Ndrek Guri; përfaqësuesi i Shoqatës “Mirëdita”, zoti Gjon Bruçi; Anëtar Nderi të Shoqatës, profesor Ahmet Osja e Gjergj Preluca.

Konferencën e hap Sekretari i Shoqatës, zoti Luigj Shyti, i cili pasi bëri prezantimin e pjesëmarrjes në Konferencë, uroj mirëseardhjen të ftuarve dhe miqve, prezantoi Presidiumin drejtues të Konferencës, sekretarinë dhe komisionin e votimit, i dha fjalën Kryetarit të Shoqatës, zotit Ndue Sanaj, për të mbajtur materialin e paraqitjes së realizimeve të pesë viteve 2014 – 2018.

Pas tij ju dha fjala zotit Pale Lera, për të paraqitur të ardhurat e shpenzimet e viteve 2014-2018.

Pas paraqitjes së këtyre dy materialeve, u kalua në diskutime. Diskutuan anëtarë të Kryesisë Prele Milani, Lazer Kodra, Roza Pjetri e Gjergj Leqejza; anëtarët e shoqatës, Mikel Kopsaj, Klodiana Serraj, Suela Ndoja, Zef Bari e Prelë Shytani kryetar i Këshillit të Shoqatës.

Përhëndetën Konferencën Frasher Racaj, në emër të Shoqatës “Martin Dreshaj”, Gjon Bruçi, në emër të Shoqatës “Mirëdita”, Ndrek Guri në emër të Shoqatës “Dukagjini”, në Miçiga dhe Ilmi Kurti, në emër të Shoqatës Atdhetare “Malësia e madhe”.


Konferenca, në mbyllje të diskutimeve, miratoj punën dhe veprimtarinë 5 vjeçare të kryesisë dhe shoqatës nga Konferenca e V deri në konferencën e VI, u miratua plani i Veprimtarive të Shoqatës së bashku me projekt Buxhetin për pesë vitet e ardhshme, 2019 -2024. Pastaj u miratuan disa ndryshime në statutin e shoqatës që u pa e nevojshme, për ti shërbyer më mirë punës.

Pastaj drejtuesi i seancës Luigj Shyti, ftoi komisionin e zgjedhjeve që të marrë drejtimin e konferencës, i cili zuri vend në presidiumin e konferencës. Filloj, kështu, procedura e zgjedhjeve. Kryetari

miqtë u shtrua një dreke.

Me 25 tetor 2018 u zhvillua faze e dytë e zgjedhjeve të shoqatës. Në këtë fazë do të zgjidhej kryetari dhe kryesia e këshillit, si dhe do të miratohej struktura e krye-

dhe të anëtarëve të kësaj kryesie. Kryetar i Këshillit të Shoqatës u zgjodh avokat Agim Martini. Gjithashtu, po me propozim të zotit Ndue Sanaj u miratuan strukturat e Kryesisë së Shoqatës Atd-



i këtij komisioni, Aleks Dushi, njoftoj se nuk kishte asnjë person të vetofruar për në postin e kryetarit të shoqatës, dhe ftoj të pranishmit që të bëhen propozime nga salla. Zoti Gjergj Leqejza propozoi që në postin e kryetarit të rizgjidhet zoti Ndue Sanaj. Nuk pati propozime të tjera. U hodh në votim të hapur dhe u miratua me konsensus të plotë, pa asnjë kundërshtim. U kalua pastaj në zgjedhjen e Këshillit të Shoqatës. Komisioni i zgjedhjeve kishte regjistruar 35 persona për në këtë këshill, prej të cilëve duhet të dilnin 25 persona. Me votim të fshehtë dolën 25 anëtarët e këtij këshilli. Këtu u mbyll faza e parë e zgjedhjeve. Në mbyllje të kësaj faze me

sisë së shoqatës. Sipas statutit, këtë fazë mbledhjen e këshillit e drejtoj Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj. Me propozimin e tij u bë zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Shoqatës

hetare “Dukagjini”. Kështu u kompletuan të gjitha strukturat drejtuese të shoqatës.

Korrespondenti i gazetës “Dukagjini”



PARAQITJA E REALIZIMEVE NGA KONFERENCA E V DERI NË KONFERENCEN E VI

- DOMOSDOSHMERI E EMANCIPIMIT SHOQËRORE TË BASHKËSISË DUKAGJINASE -

Të nderuar delegate të Konferencës së VI të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar miq!

Të nderuar të ftuar!

Vijmë në konferencën e VI me realizime jo të pakta. Ne, vijmë të ecim bazuar në shprehjen filozofike: "Mos shko aty ku të shpie shtegu, por shko atje ku nuk ka shteg dhe lë gjurmë!" Pra, ne e filluam punën në rrugë pa shteg, por e kishim të qartë misionin tonë. Ishin dukagjinasi intelektual, të ndërgjegjshëm për detyrën që i kishim vënë vetes. Prandaj ndjehemi krenar para bashkësisë dukagjinase dhe kudo shtrihet shoqata, para jush miq e mike, për arritjet në tërësi të Shoqatës, por në veçanti në këto pese vite e fundit. Pra, ecëm në rrugë të pahapura, në rrugë pa shteg, por bëmë rrugë, hapem shtigje dhe lamë gjurmë të pashlyera për bashkësinë tone, për bashkësinë shkodrane dhe deri në atë kombëtare. Në këto arritje, është mendimi e munda i juaj, në veçanti i anëtarëve të kryesisë, për të cilën ju falënderoj dhe ju shpreh mirënjohjen e thelle.

Në arritjet e këtyre pese viteve, është dhe kontributi i pushtetit vendor, i bashkisë Shkodër, i Qarkut Shkodër, i Prefekturës Shkodër, i njësive administrative, dhe të institucioneve të tjera të Shkodrës, në veçanti i Universitetit "Luigj Gurakuqi", me të cilët bashkëpunuam, na kane mbështetur deri në strukturat më të larta të Shtetit, pa të cilën ndoshta disa arritje nuk do të ishin sot prezent në këtë konferencë.

Në këto pese vitet, arritjet kryesore janë:

Së pari, Kryesia e Shoqatës pasi vendosi të nxjerre gazetën "Dukagjini", e cila që nga dhjetori 2003 e deri më sot nuk është ndalur duke arritur në 180 numra, fale përkushtimit të redaksisë së saj të drejtuar nga Prele Milani, Lazer Kodra dhe Luigj Shyti, Sekretari i Shoqatës, të cilët bënë të mundur të afrojnë pranë kësaj gazete, që nga Australia e largët, SHBA, Evropa dhe të hapësirave shqiptare, që nga Kosova Lindore e deri te Rrozhaja, që nga Saranda e deri te Peja e Tuzi, plote 485 autore, me 2 572 artikuj të ndryshëm.

Botimi i gazetës "Dukagjini" nuk do kishte vijuar pa kontributin financiar të 55 dukagjinaseve, me një vlerë prej 3 493 260 lekë, kryesisht të Gjergj Leqezjes, të Ndue Ftonit e të Mhill Prronit, të cilët janë "NDERI" i shoqatës. Viti i XV i botimit të saj, u festua me datën 30 dhjetor 2017, në mjediset e Bar-Restorant "Tradita", me mbështetjen e zotit Gjon Dukgilaj dhe të Preke Nike Gjonaj.

Mirënjohje për të gjithë ata që morën kohë nga koha e tyre e çmuar dhe menduan, punuan e futën mendjen në punë për të qenë pjesë e gazetës "Dukagjini"!

Mundësori i urojmë me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin edhe në të ardhmen!!"

Së dyti, në këto pese vite janë realizuar apo marre pjese në 46 veprimtari, me-



satarisht 9. 2 veprimtari në vit, mes tyre janë paraqite 11 libra.

Së treti, në këto pese vite, janë dekoruar personalitete e figura të rëndësishme në jetën e bashkësisë dukagjinase, si: atdhetari Mehmet Shpendi dhe profesor Kole Prela, me dekoratën "Nderi i Kombit", Monsinjon Angelo Massafra,



me dekoratën "Nënë Tereza" dhe poeti Frederik Rreshpja, me titullin "Mjeshtër i Madh".

Me datën 23 mars 2017 u arrit diçka e veçante, se në mjediset e Presidencës u zhvillua ceremonia e dekorimit të zonës së Dukagjinit, me dekoratën "Nderi i Kombit".

Së katërti, me datën 14 tetor 2017, në mjediset e Rektoratit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" u zhvillua Simpoziumi Shkencore, me temë "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", me pjesëmarrjen nga trevat shqiptare, në veçanti nga Peja, Kaçaniku e shoqata analoge dhe në mes tyre Rektori i Universitetit profesor doktor Adem Bekteshi. Materialet e këtij simpoziumi u botuan në një libër të veçante, po me këtë titull, me mundësorin Kole Çardaku, "Nderi i Shoqatës".

Së pesti, në vitin 2015, Shoqata arriti kulmin e punës së saj, se u ngritën



dy monumente: Njëri, në kuadrin e 100 vjetorit të rënies së atdhetarit Mehmet Shpendi, dhe tjetri, në kuadrin e 90 vjetorit të lindjes së albanologut Martin Camaj. Gjithashtu, në kuadrin e 100 vjetorit të Qëndresës së Dukagjinit, në Plan, kundër ushtrive malazeze, në muajin korrik 1915, u rindërtua lapidari i të rënëve,

mundur të mblidhet fondi përkatës. Personat që kane kontribuar janë publikuar në gazetën "Dukagjini" nr. 145. Për të gjithë ju, jemi shumë mirënjohës aq sa nuk gjejmë fjalë të shprehim mirënjohjen ndaj tyre, por gjithsesi historia do të shkruaj për ta.

Nga realizimi i kësaj nisme dhe dekorimit e figurave kryesore të bashkësisë dukagjinase dhe në veçanti të dekorimit të zonës së Dukagjinit, duhet theksuar:

a) Edhe një here prezantuar para opinionit qytetar e instancave shtetërore solidaritetin dukagjinasi të trashëguar në shekuj. Në qoftë se nuk do të ishte ky solidaritet, nuk mund të mblidhej fondi përkatës dhe as nuk mund të mendohej të ndërtoheshin këto monumente.

b) Treguam para të tjerëve përgjegjësinë atdhetare e intelektuale të anëtarëve të shoqatës sonë në marrjen e nismave të tilla me vlera nacionale.

c) Treguam, se sa të vendosur jemi, sa të përgjegjshëm jemi për detyrat që marrim në mënyrë vullnetare, për t'i bërë realitet ato dhe sa e vendosur dhe e përkushtuar është shoqata në realizimin e misionit të saj.

d) Gjithashtu treguam, se pa bashkëpunimin me strukturat vendore nuk mund të jepej miratimi për vendosjen e monumenteve, pa pëlqimin e kryetarit të Bashkisë, z. Lorenc Luka! Nuk mund të dekorohet atdhetari Mehmet Shpendi, pa mbështetjen e ish Kryetarit të Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu! Nuk mund të mendohej të dekorohet zona e Dukagjinit pa mbështetjen e Kryetares së Bashkisë, zonjës Voltana Ademi.

e) Realizimi i kësaj nisme tregon edhe njëherë domosdoshmërinë e krijimit të kësaj shoqate për bashkësinë dukagjinase, e cila gjithnjë e më shumë duhet të forcohet e të eci përpara, sepse misioni i saj është i pafund ... Detyra të tjera na presin, të cilat patjetër kërkojnë punën tonë të pakursyer, por asnjëherë punën tonë me kushte. Le të ketë debate, por jo ultimatumet, sepse Dukagjini është i të gjithëve.

f) Kjo përvojë na mësojë, se secili nga ne, është i domosdoshëm

◀ në realizimin e misionit të shoqatës. Pra, për të ecur më përpara duhet të jemi më bashkëpunues e më të pranueshëm njeri me tjetrin.

g) Duke u nise nga realizimi i kësaj nisme, kemi të drejtën morale, që të ftojme dukagjinast, në veçanti brezin e ri, të bëhen pjesë e shoqatës “Atdhetare Dukagjini”, sepse nevojitet kontributi i tyre..

h) Në këto pese vite, arritjet përkatëse nuk mund të ishin realizuar pa kontributin financiar të 230 mundësorëve, që 43 vete janë për përgatitjen e realizimin e veprimtarive të shoqatës, me një vlerë prej 2 523 380 leke dhe të 187 mundësorëve për ndërtimin e dy monumenteve, me një vlerë prej 9 889 710 leke, në të cilën bashkësia dukagjinase në Nju-Jork zënë 62 % e gjithë kontributit.

Të gjithëve ju urojmë, me shprehjen popullore “Paçin e dhënçin!”

i) Në gjithë këto vite, Kryesia e Shoqatës ka nderuar me tituj nderi 515 persona të fushave të ndryshme, në mes tyre 60 femra. Në mesin tone kemi 52 figura e persona me kontribute në fusha të ndryshme në jetën e shqiptarisë, “Anëtar Nderi të SHAD”, 15 persona e figura në jetën e shoqatës, “Nderi i SHAD”, 19 vetë të renë dëshmorë, janë nderuar me titullin “Mehmet Shpendi”, 23 shkrimtar, artist apo poet, janë nderuar me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”. Pra, kemi bërë përpjekje të nderojmë gjithë ata, jo vetëm dukagjinast, por dhe nga hapësirat e tjera shqiptare, që kanë dhënë shoqërisë, që kanë dhënë kombit tone.

j) Në këto vite për kontributin që kemi dhënë, për bashkëpunimin me shoqatat analoge, jemi nderuar me 18 tituj të ndryshëm nderi, nga Shoqata e vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë; nga Familja e Adem Jasharit; nga Klubi i poetëve “Ora e Maleve” në Rrozhajë; nga Ansambli Folklorik Autokton “Rugova”, në Pejë; nga Muzeu “Ivezaj”, në Tuz; nga Teatrit “Aleksandër Moisiu”, në Pejë dhe nga organizatorët “Dita e Plisit”, me qendër në Kline.

Të nderuar delegat, miq e të ftuar! Të gjithë këto arritje dhe nderime në këto 15 vite, në veçanti në pese vitet e fundit, janë “prone” vetëm e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Ajo, në jetën e saj 15 vjeçare ka marre 244 vendime, nga strukturat vendimmarrëse të saj, duke filluar me Themelimin e Shoqatës, Programin e Statutit, me emrin e Gazetës sonë “Dukagjini”, dhe shume vendime të tjera të rëndësishme.

Të nderuar delegate! Të nderuar Miq! Të nderuar të ftuar!

Shoqata në këto vite ka bërë të mundur, që sot, gjerat t’i shikojmë më me optimizëm drejt emancipimit të shoqërisë, drejt shoqërisë së hapur, në themel së cilës janë vlerat e individit.

Megjithatë, në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës dhe me miratim të Kryesisë së Saj, në këtë Konferencë pune do të ndalemi në disa probleme që na kanë shqetësuar në këto vite dhe dëshirojmë që të mos përsëriten në ardhmen:

Së pari, Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” ka punuar në baze të një statuti, në të cilin janë të përcaktuar detyrat e të drejtat e secilit anëtarë të shoqatës, të secilit anëtarë të strukturave drejtuese.



Por kërkesat e statutit nuk po zbatohen plotësisht. Këtë problem e kemi ngritur dhe në raste të tjera, por duket se, ne nuk kemi ditur të kërkojmë, të organizojmë, ose disa anëtarë të shoqatës kanë ardhur në shoqate për “luks” dhe ne kemi renë në prehrin e tyre, në veçanti kryetaret e

Së treti, Shoqata është krijuar, ti bashkojë dukagjinast, për ti dhënë emrin që meriton Dukagjini. Të ndare, të përçarë nuk mund të zësh vendin që të takon. Figurat e dekoruara të zonës sonë janë propozuar nga Kryesia e Shoqatës. Për këtë i jemi shumë mirënjohës Insti-

Bashkisë Shkodër, për vendosjen e emrit të “Mark Lules” shkollës 9-vjeçare, në Lagjen Mark Lula, ndërsa sot çdo gjë do të ishte kuptimplote po t’i vendosej emri i Doktor Profesor Kole Preles “Nderi i Kombit”.



degëve.

Në nenin 7, përcaktohet: “... Kuota vjetore do të jete 1 000 leke në vit, por kanë paguar në këto 5 vite, vetëm 5 % e

tucionit të Presidentit, që na ka miratuar propozimet tona. I jemi shumë mirënjohës Presidentit Alfred Moisiu, që na ka dekoruar me dekoratën “Shqiponja e

Sigurisht, që dhe ne anëtarët e kryesisë duhet të kishim bashkëpunuar më shumë me shkollën, me anëtarët e këshillit e më gjere, dhe besoj se në të ardhmen nuk do



anëtarësisë. Po të paguheshin kuotat, sot do të kishim zyrën e shoqatës, ose do mundësohej botimi i dy librave, pasi do arkëtohej një shume prej 215 000 lekësh. Anëtar shoqate duhet të jete vetëm ai që zbaton Statutin.

Së dyti, në nenin 3, përcaktohet: “Degët e shoqatës krijohen mbi baze rrethi, ... në hapësirat shqiptare ... dhe në diasporë, kur ka mbi 8 vete. Ato derdhin në llogarinë e shoqatës 50 % të të ardhurave të tyre që sigurohen sipas statutit, pjesa tjetër përdoret për nevojat e degës Ky nen i statutit nuk po zbatohet nga degët, me përjashtim të degës së Tiranës, e cila lëviz diçka, mundohet të zhvillojë ndonjë veprimtari.

Artë”, Mehmet Shpendin, në kuadrin e 90 vjetorit të rënies së tij; Presidentit Bamir Topi, që na ka dekoruar piktorin Lind Delija dhe albanologun Martin Camaj, me dekoratën “Nderi i Kombit”; presidentit Bujar Nishani, që na ka dekoruar atdhetarin Mehmet Shpendi, profesor Kole Preen e zonën e Dukagjinit, me dekoratën “Nderi i Kombit” dhe poetin Frederik Rreshpja, me titullin “Mjeshtër i Madh”; presidentit Ilir Meta, që na ka dekoruar Monsinor Angelo Massfra, me dekoratën “Nënë Tereza”. Për t’u realizuar këto dekorime ishte e domosdoshme mbështetja e strukturave të pushtetit vendor, të cilat na kanë mbështetur deri në nivelin më të larta të shtetit, deri te Institucioni i Presidencës. Por jemi plotësisht dakord për mos-miratimin nga Këshilli i

na mungojë ky bashkëpunim, por ata vete duhet të mendojnë më thelle, kur merren vendime të tilla kaq të rëndësishme, siç është pagëzimi i një shkolle.

Ne, duhet ta respektojmë të kaluarën, ta studiojmë dhe të përgjithësojmë vlerat që duhet t’u trashëgohen brezave. Por ne, nuk duhet të ecim me mendime orientale, të cilat po na ndajnë nga njeri-tjetri, duke vu në mes të këtij bashkimi “UNIN, pasi kjo e dëmton mbarëvajtjen tone. Duke vu në mes të këtij bashkimi mendimin oriental, primitiv “PERJASHTIMIN”, që do të thotë, kush nuk është në një mendje me mua, përjashtohet, është armiku im dhe si i tille nuk duhet të jetoje. Kjo nuk është tradicionale, nuk është fetare, nuk është ligjore. Ky qëndrim tregon mungese emancipimi.

Ne shpesh theksojmë, se pushimi osman, në mes të tjerave nuk na la të mësonim të lexojmë e të shkruajmë gjuhen e nenës, gjuhen Shqipe. Në fakt themi një të vërtetë të pamohueshme, një të vërtetë të madhe. Por, nga ana tjetër ende komunikojmë me strukturat e atij, me të cilat na sundoje gati pese shekuj, dhe ne, në vend që të përdorim fjalën shqip “fshat apo krahinë”, përdorim “bajrak/u” i asaj krahine apo i këtij fshati! Pse? Ne ende në mort, në shpija, në dasma vijojmë e flasim turqisht duke përdorur fjalët “hoxhgjelden, byrm, nafakën, baftin, sofrën” e të tjera e të tjera! Pse?

Pse, ne na duket vetja më i mirë, se të tjerët? Malësia e Madhe, Nënshkodra, Bregu i Matës kane ndryshuar ritet mortore, ndërsa ne dukagjinasi vijojmë në të tonën! Ne, nuk po zbatojmë ato që kemi trashëguara, por i kemi thelluar ato keqas?! Mos valle, kush ka të drejtë? Kemi ne, apo banoret e krahinave fqinj? Secili nga ne, në këtë Konferencë dhe jashtë saj, do të thotë: “Ne nuk kemi të drejte!”

Në periudhën, 1991-2012 janë vrare për arsye të ndryshme 145 vete. Ne dukagjinasi, a besojmë në Zotin, në fenë katolike? Po! Ai njohim 10 urdhnimet e Tenzot, që në urdhnim e peste, theksohet “... mos vra se, me Tenzonë hynë në gjak ...!” Po. Atëherë, pse kërkojmë të zgjidhim fenomenin e gjakmarrjes me metoda arkaike, kur është shteti i demokracisë? Një qëndrim i tillë, është i papranueshëm.

Mund të ketë dhe të tjera problematika, por duhet të jete shoqata, ajo që duhet t'i sheshte ato, duke u mbështetur në punën cilësore, intelektuale e emancipuese. Këto gjera nuk lëvizin me urdhër, por me ngritjen e vetëdijes shoqërore e vokacionin bashkëkohor të shoqërisë dukagjinase. Është e lehtë të themi “Dukagjin krenaria ime”, por duhet punë t'ia ruajmë e ngremë më lart krenarinë. Asnjë hiperbolizim apo status i llojit të veçantë nuk ia rrit vlerat dukagjinit.

Këto janë disa nder problemet, që shoqata në bashkëpunim me intelektualët dukagjinasi, shkodrane e mbare shqiptar, me strukturat e pushtetit vendor dhe atij arsimor, duhet të punojë më me përgjegjësi për të ardhmen.

Prandaj, besojmë, se kjo konferencë me diskutimet tuaj, me vendimet e saj, do të ndikojë në reformimin e mëtejshëm të strukturave të Shoqatës, me qëllim, që të gjithë të jene aktiv dhe më të përgjegjshëm ndaj misionit të saj.

Në cilësinë e kryetarit të Shoqatës, në emër të kryesisë së saj, duke u bazuar në arritjet dhe në mos arritjet, në përparimin shoqërore që është bërë, ju propozoj:

1-Misioni i Shoqatës të ndryshojë: “Misioni i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në të ardhmen të **“Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Dukagjinit, për emancipimin shoqëror të dukagjinasi kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri - tjetrin, të ecim përpara drejtë standardeve evropiane”.**

2-Mbledhjet e Përgjithshme të degëve, të bëhen brenda muajit nëntor 2018 dhe me ata anëtar, që do të marrin pjesë



në këto mbledhje, të hapet regjistri i ri anëtarëve e anëtareve të Shoqatës në baze dege dhe mbi bazën e tyre të rihapet ai, në baze të Shoqatës.

3-Të rritet përgjegjësia e secilit anëtar të shoqatës, në zbatimin e kërkesave të Statutit. Nuk mund të jesh anëtar apo

anëtare shoqate, në qoftë se nuk je aktiv, në qoftë se nuk paguan detyrimin fillestar, atë të kuotës, në fillim të muajit Janar të çdo viti nëpërmjet numrin e llogarisë bankare.

4- Kryetarët e degëve, degët në tërësi, nga të cilat përbëhet Shoqata, duhet

të jenë aktive. Nuk mund të jete degë, një degë, që jo vetëm nuk kujdeset për mbledhjen e kuotave, por as nuk mblidhet një herë, nuk organizon asnjë veprimtari. Prandaj zgjedhjet në baze dege duhet të organizohen mire dhe të kenë parasysh që në krye të saj të zgjedhin njeriut më



aktiv, të punës e të përkushtuar.

5- Në të ardhmen duhet të punojmë më shumë për të afruar e për të komunikuar me intelektualët dukagjinasi dhe më gjere, duke bindur ata, se me indiferencën e tyre dëmtohet shoqata, dëmtohet bashkësia dukagjinase.

6- Për pese vitet e ardhshme propozoj këto veprimtari kryesore:

* Vijimi i botimit të gazetës “Dukagjini”, me 16 faqe;

* Studimi mbi vijimin e shkollimit të fëmijëve në zonën tonë dhe propozimi i masave konkrete në ndryshimin e gjendjes.

* Përgatitja e zhvillimi Konferencës shkencore, me teme: “Emancipimi shoqërore i bashkësisë dukagjinase, domosdoshmëri e kohës dhe roli i Shoqatës në realizimin e tij”;

* Studimi i objekteve historike të zonës së Dukagjinit, organizimi i zbulimeve arkeologjike, dhe dalja një here e mirë nga mendësitë primitive;

* Përgatitja e zhvillimi i një shëtitje turistike me studente të fushave të ndryshme, kryesisht histori, etnografi, gjeografi e të tjera;

*Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge dhe zgjerimi i veprimtarive në hapësirat shqiptare;

* Rindërtimi i monumentit të albanologut Martin Camaj dhe ri-inaugurimi i tij, me rastin e 94 vjetorit të lindjes së tij.

Këto propozime, sigurisht kane një kosto jo të vogël, e cila mund arrije deri në 3 158 000 leke, por si deri tani dukagjinasi kudo janë do të jenë bujar për të kontribuar në realizimin e tyre, si një domosdoshmëri e kohës.

Ju faleminderit për vëmendjen që më kushtuat!

NDUE SANAJ,
KRYETARI I SHOQATËS
ATDHETARE “DUKAGJINI”



PARAQITJA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE NË VITET 2014 - 2018

Të nderuar delegate, miq e të ftuar!

Në paraqitjen e punës së Shoqatës At-dhetare "Dukagjini" në këto pese vite, që bëri Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj, ndoshta ndonjëri dhe tha, se si është e mundur të arrihen gjithë këto realizime me një pune kaq vullnetare! Por, ja që janë arritur, fal një vullneti të pa ndalur, të një përkushtimi të jashtëzakonshëm të Kryesisë së Shoqatës para asnjë pengese qoftë objektive apo subjektive. Por, këto arritje nuk do të ishin të mundura pa një mbështetje financiare të dukagjinave kudo janë, të cilët po i paraqesim më poshtë:

Këto mundësime financiare po i ndajmë në dy grupe:

Grupi i parë, në mbështetjen financiare të realizimit të veprimtarive të Shoqatës.

Për të përgatitur e realizuar 46 veprimtari të shoqatës dhe botimin e gazetës "Dukagjini", që nga numri 123 e deri te numri 179, gjithsej 57 numra, janë 44 mundësore, që nga 500 deri në 746 950 leke, përfshi shitjen e gazetës (27 465 leke) dhe kuotat e anëtarësisë (49 150 leke), gjithsej 2 523 380 leke. Prej tyre, 1 120 500 leke janë harxhuar për botimin e gazetës dhe diferenca prej 1 402 880 leke janë harxhuar për përgatitjen e realizimin e veprimtarive të shoqatës.



jave;

Nga Miçigani, kane kontribuar 62 vete, me shumën e përgjithshme 9400 dollarë dhe 300000 leke;

Nga Belgjika, kane kontribuar 14 vete, me shumën 1500 euro;

Nga Shkodra e Tirana, kane kontribuar 26 vete, me shumën 867000 leke, 730 dollarë dhe 6040 euro, që nga 2000 leke dhe deri në 500000 leke e 4000 euro.

Të gjitha, me shumën e përgjithshme **9889710 leke** dhe të kthyer në euro, **70681 euro**.

Kjo shumë është shpenzuar: Preventivi, për ndërtimin dhe inaugurimin e monumentit të atdhetarit Mehmet Shpendi:

Skulptori 16000 euro,

ose 2240000 leke;

Derdhësi në bronz 16 000 euro,

ose 2 240 000 leke;

Bazamenti 2 000 euro,

ose 280 000 leke;

Germat 122 euro,

ose 17 000 leke;

Transporti nga Tirana 72 euro,

ose 10 000 leke;

Inaugurimi i monumentit 1318 euro,

ose 184 560 leke.

Gjithsej 35 512 euro,

ose 4 971 560 leke.

Gjithsej 34 104 euro,
ose 4 774 350 leke.

Për rindërtimin e lapidarit në Qeresh, në kuadrin e 100 vjetorit të Qëndresës së Dukagjinit, në Plan **1 028 euro**, ose **143800 leke**.

Lista e gjithë kontribuuesve i bashkëngjitet kësaj paraqitjeje.

Të gjithë kontribuuesve, ju shprehim mirënjohjen e thelle, megjithëse nuk gjejmë fjalët e duhura për ti falënderuar, por e kemi të qarte se koha, historia ka për të shkruar gjate dhe shumë për ta, I urojmë me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin!"

Të nderuar delegate!

Të nderuar miq e të ftuar!

Gjithë ky kontribut, duhet të na bëjë më të ndërgjegjshëm anëtarët e anëtarët e Shoqatës për të qene më kërkuës ndaj vetes për të zbaruar kërkesat e statuti.

E theksoj ketë, se në këto pese vite janë arkëtuar nga kuotat 49 199 leke, barazi afërsisht me 5 % e asaj që duhej të ishte arkëtuar në këto pese vite.

Në këto pese vite, afërsisht duhet të ishin arkëtuar 1 000 000 leke, me të cilat sot shoqata do të kishte një zyre, që tashme e ka të nevojshme, mund të kishte botuar dy librat, që i ka gati për botim, do të kishte botuar disa numra gazete.

Anëtari i shoqatës duhet ta ketë të qarte, se në çdo muaj Janar, kuota duhet paguar dhe nuk ka nevojë për ndonjë thirrës, por ai vete duhet të kërkojë seksionin ekonomik financiar të shoqatës, për të paguar detyrimin vjetor prej 1 000 leke nëpërmjet bankës, që është e publikuar në kreun e gazetës.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Pal Lera
Shkodër, 21 tetor 2018

Në vitin 2014 janë mundësuar	533 200 leke, prej tyre janë shpenzuar 419 180 leke
Në vitin 2015 janë mundësuar	316 880 leke, prej tyre janë shpenzuar 362 500 leke
Në vitin 2016 janë mundësuar	335 810 leke, prej tyre janë shpenzuar 379 150 leke
Në vitin 2017 janë mundësuar	1 032 375 leke, prej tyre janë shpenzuar 861 930 leke
Në vitin 2018 janë mundësuar	305 115 leke, prej tyre janë shpenzuar 484 470 leke
Janë në gjendje arke	1 650 leke

Mundësorët e këtyre pese viteve janë:

Agron Hasanaj, Anton Kosteri, Arber Raja, Agim Gilaj, Bal Vuksani, Dede Toka, Edmond Terthorja, Gjergj Leqejza, Gjovalin Shyti, Gjin Brigja, Gjon Dukgilaj, Kole Çardaku, Komuna Rrethina, Lulash Gjeloşi, Luigj Ladhinaj, Mark Zhuri, Mhill Prroni, Meritan Spahija, Miter Ndreshaj, Mark P. Kulla, Ministria e Kulturës, Mikel Kopsaj, Martin Martini, Mirela Gjoni, Mhill Ftoni, Mhill Bregu, Motra Dukate Radoja, Ndue Ftoni, Nikoll Gerla, Ndoc Bregu, Ndoc Selimi, Pal Lera, Prek Nik Gjonaj, Prenda Shpendi, Roza Pjetri, Sokol Cubi, Sokol Sterbyçi, Tonin Marku, Tonin Kamberi, Vate Musa, Vito Sanaj e Zef Gjeta.

Grupi i dytë, ata që na mundësuan financiarisht për ndërtimin e dy monumenteve dhe vendosjen dhe tyre në qytetin e Shkodrës, atë të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe të albanologut Martin Camaj.

Në vitin 2015 u ndërtuan dhe u inauguruan dy monumente, i atdhetarit Mehmet Shpendi, në kuadrin e 100 vjetorit të rënies së tij dhe albanologut Martin Camaj, në kuadrin e 90 vjetorit të lindjes së tij. Gjithashtu u rindërtua lapidari në Qeresh, në kuadrin e Qëndresës së Dukagjinit, në Plan, kundër ushtrive malazeze, në muajin korrik 1915, në të cilën ranë dhe u vranë 81 luftëtarë dhe banorë të këtij fshati.

Ishte një nisem e guximshme e Kryesisë së Shoqatës, por që ja arriti qëllimit, në saj të mbështetjes së pushtetit vendor Shkodër dhe ndihmës financiare të pak-

ursyer të 187 personave, që nga Nju-Jorku e deri në Shkodrën tonë.

Nga Nju-Jorku kane kontribuar financiarisht 77 persona, që nga 40 dollarë e deri 5 000 dollarë, gjithsej 52 500 dollarë, duke mbuluar 62 % të gjithë nevo-

Preventivi, për ndërtimin dhe inaugurimin e monumentit të albanologut Martin Camaj:

Skulptori 15 000 euro,

ose 2 100 000 leke;

Derdhësi në bronz 16 000 euro,

ose 2 240 000 leke;

Bazamenti 1 500 euro,

ose 280 000 leke;

Transporti nga Tirana 72 euro,

ose 10 000 leke;

Inaugurimi i monumentit 1 531 euro,

ose 214 350 leke.



NJOFTIM!

a) Në konferencën e VI të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në detyrën e Kryetarit të Saj, u rizgjodh zoti Ndue Sanaj

b) Këshilli i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i zgjedhur në Konferencën e VI të saj, me datën 21 tetor 2018, përbëhet:

Agron Hasanaj, Age Martini, Agim Gilaj, Arbër Shytani, Anton Kosteri, Aleks Dushi, Diana Bungu,

Dukate Bregu, Edmond Tërthorja, Elida Delija, Gëzim Zefi (Suta), Gjergj Leqejza, Klodiana Serraj,

Kole Çardaku, Lazer Kodra, Luigj Mila, Luigj Shyti, Ndue Nikaj, Mikel Kopsaj, Prele Milani, Pale Lera, Suela Ndoja, Roza Pjetri, Vilson Peshkaj, Vjola Shqau, Tringa Rapi, Zef Gjeta, Marijan Ndershtiqaj, dhe

- 1- Kryetari i degës së Shkodrës
- 2- Kryetari i degës së Tiranës
- 3- Kryetari i degës së Lezhës
- 4- Kryetari i degës së Kurbinit
- 5- Kryetari i degës së Malësisë së Madhe

c) Këshilli i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në mbledhjen e tij, me datën 25 tetor 2018, zgjodhi strukturën drejtuese të saj:

- 1- Av. Agim Martini, Kryetari i Këshillit të Shoqatës

- 2- Mjeku Ndue Nikaj, N/Kryetari i Këshillit të Shoqatës
- 3- Zonja Dukate Bregu, Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës
- 4- Zoti Aleks Dushi, Sekretari i çështjeve organizative të Shoqatës
- 5- Zoti Luigj Mila, Sekretari i çështjeve juridike të Shoqatës.

d) Këshilli i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në mbledhjen e tij, me datën 25 tetor 2018, miratoj përbërjen e Kryesisë së Shoqatës dhe anetarët e saj:

- 1- Zoti Gjergj Leqejza, N/Kryetari i Pare i Shoqatës,
- 2- Zoti Agron Hasanaj, N/Kryetari i Shoqatës për ekonominë e financën,
- 3- Zoti Mikel Kopsaj, N/Kryetari i Shoqatës për marrëdhëniet me pushtetin vendor dhe me shoqatat analoge
- 4- Zoti Prele Milani, Nen Kryetari i historiografisë e kulturës,
- 5- Zoti Anton Kosteri, Sekretari i Shoqatës,
- 6- Zoti Kole Çardaku, Kryetari i Seksionit të ekonomisë e financës,
- 7- Zoti Vilson Peshkaj, Kryetari i Seksionit të historiografisë,
- 8- Zonjusha Roza Pjetri, Kryetare e Seksionit të kulturës popullore,
- 9- Zonja Viola Shqau, Kryetare e Seksionit të veprimtarive artistike,
- 10- Zoti Arber Shytani, Kryetari i Seksionit të marrëdhëniet me shkollat,
- 11- Zoti Marian Nderhtiqaj, Kryetari i Seksionit të marrëdhëniet me Rininë,
- 12- Zonja Elida Delija, Kryetare e Seksionit të marrëdhëniet me Gruan,
- 13- Zonjusha Suela Ndoja, Kryeredaktore e redaksisë së gazetës “Dukagjini”
- 14- Zoti Lazer Kodra, Kryetari i Seksionit të veprimtarive me librin.
- 15- Zonja Age Martini, Kryetare e Seksionit të projekteve,
- 16- Zonjusha Klodiana Serraj, kryetare e Seksioni i marrëdhëniet me publikun dhe me jashtë.

Kryesia e Shoqatës

Hipoteza mbi origjinën e Gjergj Kastriotit...

(Mbajtur në simpoziumin e VI internacional, me temë “Skënderbeu në kulturën Evropiane”, mbajtur në Tiranë, i organizuar nga Unioni i shkrimtarëve dhe i kritikëve shqiptarë)

Miq të fjalës së shkruar ju përshëndes.

Me privilegjin e mundësisë për të shpreh edhe unë diçka rreth hulumtimeve të mia në kuadër të Vitit të Gjergj Kastriotit, dhe pa dashur të përsërit asgjë nga lumi i fjalëve, shprehive, pohimeve apo dhe diskutimeve të shumta që janë bërë përgjatë gjithë këtij viti jubilar, trajtesën time do ta përqendroj mbi një nga hipotezat e shumta që historiografia shqiptare na jepet mbi origjinën e Gjergj Kastriotit, ku nder të shumtat hipoteza që kjo disiplinë shkencore ofron për studentet në formatin e leksioneve, është edhe origjina e tij nga Kastrati i Malësisë së Madhe.

Në të vërtetë kjo disiplinë vetëm sa e pohon, por nuk e vërteton këtë prejardhje familjare, madje as nuk merret fare me referencat, se ku e bazon këtë hipotezë. Meqë, unë vij nga ky grup banorësh të kësaj krahine e kam pasur gjithmonë si një pikëpyetje para vetes për të kërkuar një përgjigje me baza të forta shkencore, ku vëmendjen time e kam përqendruar mbi lidhjet e mundshme të familjes së Gjon Kastriotit me Kastratin e Malësisë së Madhe. Disa prej këtyre përgjigjeve do doja ti ndaja sot me ju.

1. E drejta zakonore e Kastratit, ka një ngjashmëri të madhe me “Kanunin e Gjergj Kastriotit”, çka i bën më liberal se të gjitha kanunet e tjera.

- Gjatë hulumtimit tim mbi kanunin e Gjergj Kastriotit dhe ballafaqimit me Ligjin e Maleve, i cili ruhet ende si gojëdhënë nga të moshuarit në Malësi të Madhe e sidomos në Kastrat, në ato familje ku ruhet ende tradita, kam vënë re se ka një ngjashmëri të madhe. Kjo vihet re te organizimi familjar, mënyra e taksimit, shlyerja e detyrimit, kodi i gjakut, gjykimi i dëmit, martesë, beja për shfajësim

e të tjera. Këtu do veçoj faktin se, gruaja nën petkun e xhubletës ka pasur pak më shumë të drejta dhe autoritet për barazi



gjinore në krahasim me gruan nën hapësirat ku drejtoresh në baze të kanuneve të tjera.

2. Një tjetër referencë lidhur me këtë hipotezë e përqendroj te veshjet, traditat, mënyra e jetesës apo ritualet mortore, të cilat janë shumë të përafërta me ato të

Kastratit.

Për ta ilustruar përmend një tjetër fakt shumë domethënës, duke ju referuar fondit të materialeve të shkruara, gojëdhëna apo dhe relacioneve të ndryshme, rezultojnë se xhubleta dhe çakçirët ishin veshje tradicionale familjare të cilat u ruajtën deri vonë te kjo familje, që në krahinën e Kastratit janë ende prezent. Madje shtoj këtu edhe tendencën e studiuesve mbi xhubletën e Malësisë së Madhe, që pohojnë faktin, se ajo është e zezë me nuancat e saj si shenjë nderimi ndaj Gjergj Kastriotit, të cilit i mbajten jazin (zinë) pas vdekjes.

3. Reference tjetër është, se gjate pushtimit Sllav të Stefan Dushanit, në shekullin XI territori i Kastratit, sipas gojëdhënave ishte i mbipopulluar sa thuhej, se rrugët ishin të ngushta me kalldrëme, sa shëtiste macja tra më tra, por që u shua se ekzistuari, pasi u kthye në një fushëbetejë e përgjakshme duke shfarosur e shkrumbuar çdo gjë, që i detyroi banorët të marrin arratinë nder male për t' mos u kthyer më deri në rënie e këtij sundimi, një pjesë e të cilëve nuk u kthyen më kurrë. Gojëdhëna, të cilat gjejnë kuptim nga:

-prezenca e mbetjeve të banesave kudo në zonën fushore gjatë gjurmëve të ndryshme. -harta e Colonelit, e cila në shpjegimin territorial jep të dhëna vendbanimesh, që sot nuk njihen;

-gojëdhënat e ndryshme, të cilat kanë ardhur deri në ditët tona si legjenda apo këngët epike në tel të lahutës.

4. Referencë tjetër, është edhe martesë e motrave të Gjergj Kastriotit në krahinat fare afër Kastratit, si traditë familjare me ruajt vijimësinë e kahershme martesore, që t' mos i largohen Maleve të Malësisë, që i bën shpesh studiuesit ta quajnë edhe nënën e Gjergj Kastriotit, sllave si pasojë e ndarjes politiko-shtetërore, që përsuan këto krahina në mesjetën e vonë, pa llogaritur fare faktin se krejt ky territor ka qenë provincë kompakte me të drejta

të cinguar, ku nuk lejoheshin martesat jashtë province, tregtia, migrimi apo largimi jashtë provincës, të sanksionuara me ligj gjatë sundimit Romak e të pasuara nga ai Bizantin deri në rënie e tij.

5. Referencë tjetër, që shpesh studiuesit e anashkalojnë, është prezenca e emrit Vojsava në Kastratin e Malësisë së Madhe tek Regjistri i Kadastrës dhe i Konçensioneve për Rrethin e Shkodrës 1416-1417, ku me një shpjegim të thjeshtë ky emër gjen kuptim në traditën dhe zakonet e malësisë. Në traditën familjare, kur numri i lindshmërisë së fëmijëve të gjinisë femërore rritej (pasi tradita e donte që të lindte patjetër një trashëgimtar, mashkull) atëherë përdorej një “truk” tradicional, që vazhës së fundit i vihej një emër përcudnues apo mallkues, deri dhe emri i nënës së vet në mënyrë që fëmija pasardhës të ishte djalë. Në këtë rast emri Vojsava në t' folmen e Kastratit ka kuptim vajtues, vaj-sa-vaj...

6. Referencë tjetër përmend faktin, se në elementet zburues të xhubletës dhe çakçirëve gjejmë elementë të përkrenares dhe flamurit të Gjergj Kastriotit

7. Referencën e fundit e lidhë me këngën kushtuar organizimit ushtarak të malësorëve, ku kushtrimi për lufte përcillej nga Kruja mal më mal me thirrje. E një prej këtyre thirrjeve në traditën e maleve të malësisë ruhet ende dhe sot, si kënga maje krahu. “o po fjalë e për tel, o po thuj Gjakovë çojë e del”. Kjo këngë është një hit, pa të cilën nuk nis log, dasme apo festë familjare edhe në ditët e sotme.

Duke ju përgëzuar për organizimin e kësaj veprimtarie mjaft të rëndësishme, gjej rast të falënderoj edhe z. Selimi për ftesën.

Gjergj Kastrioti, është krenaria jone kombëtare para të cilit duhet të reflektojmë si trashëgimtarë të ndenje dhe të përgjegjshëm para gjeneratave që do vijin pas.

nga Rita Shkurtaç

Protestojmë me lule...!

Artistë dhe filozofë të ndryshëm, sidomos ata të kohëve të lashta, kanë folur për një thirrje apo frymëzim, që iu është bërë nga “Muza” ose ndonjë perëndi tjetër.

Mos u çuditni, por para disa vitesh (më falni se po e publikoj me vonesë), edhe unë pata një frymëzim të veçantë; mbase bëhet fjalë për një konsiderim që lindi nga një “krizë e thellë shpirtërore...”.

Ishte marsi i 1997-ës. Këtu në Shqipëri s’dëgjohej gjë tjetër veçse shpërthime, shkatërrime, grabitje, krisma e vrasje. Kaluan muaj dhe të dëgjohehin krisma me ndonjë viktimë u bë gjë krejt normale për shqiptarët (për mua sigurisht po). Gjatë ditëve që erdhën pas asaj pranvere të çrregulluar krismat sikur dëgjohehin më rrallë.

Fakti që më tronditi më shumë ishte se në fshatin ku studioja, një mëngjes të freskët, poshtë qiellit me pak re, u gjet rastësisht, në oborrin e shtëpisë së saj, trupi i pajetë i një gruaje. Një plumb qorr

e kishte goditur në kokë, - pëshpëritej prej të gjithëve. Bëhej fjalë për nënën 36 vjeçare të një shoqes sime. U zemërova shumë dhe nuk dija si ta shprehja zemërimin tim. Ajo kishte vdekur dhe nuk dihej se kush e kishte vrarë; padrejtësisht ia morën jetën dhe askush nuk mbante përgjegjësi për një krim të tillë. Po përse ekzistojnë armët? Përse vazhdon prodhimi i tyre kur në botë çdo ditë shtohet niveli i urisë dhe i vdekjeve të parakohshme apo i vdekjeve të fëmijëve thjesht për një aspirinë? A është e drejtë të kemi një interes për armë kur na mungojnë gjëra të ndryshme parësore, të cilat sigurisht do të mund ta shtonin cilësinë e jetës sonë?

Që atëherë fillova të besoj se plumbat po vrisnin njerëz, po vrisnin shqiptarë, po vrisnin prindër, vëllezër e motra! Sidoqoftë, kështu kaloi viti 1997!

Po sot, ç’po bëhet me Shqipërinë dhe me shqiptarët? A mund të vazhdohet akoma kështu? Vëllezërit tanë politikanë, a

punojnë për Shqipërinë? Apo tallen me shqiptarët? Qeveritë e qeveritarët, herë pas here ndërrojnë, e ne këtu poshtë vazhdojmë t’iu bëjmë tifozllëk.

Besoj se ka ardhur koha që të mos ndikojë situata mbi ne, por ne të ndikojmë mbi situatën. E situata sigurisht duhet marrë në dorë! Jo me dinakëri, me dhunë e armë, apo me terror, siç mendojnë disa... Është e mundur të protestojmë me lule... Ju duket çudi ndoshta! Besoj se lulet do të jenë arma më e fortë, me të cilën do të luftojmë për qeveri me të vërtetë demokratike e për një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Një lule më shumë, një vrasës më pak!

Ka ardhur koha, dhe kjo është, që të gjitha energjitë tona të vihen në shërbim të së mirës, madje në shërbim të më të mirës për ne dhe për të tjerët: ka ardhur koha që edhe aspektet tona më negative të punojmë që t’i shndërrojmë në një forcë të re për të bërë mirë.

Është e mundur të ndërtojmë një botë pa armë, atë botë të re që e ëndërruan paraardhësit tanë dhe që kaq shumë e duam edhe ne: unë besoj se kjo utopi do të bëhet realitet. Edhe Fjala e Zotit, thotë: “Shpatat e veta do t’i kthejnë në plorë e heshtat në drapërinj. Një popull nuk do të ngritë shpatën kundër një populli tjetër dhe më s’do të ushtrohen për luftë”. (Is. 2, 4)

Jezusi, Princi i Paqes, Ai që “shpinën ua solli atyre që e rrihnin... dhe fytyrën e Tij nuk e largoi nga të sharat e pështymat” (krhs. Is. 50, 6), na ndihmoftë që të ushtrohemi gjithmonë dhe kudo për paqe dhe njësim!

Dhe do të shohim me sytë tanë tek realizohet pak e nga pak, në mënyrë të mahnitshme, ajo fjala profetike: “Shkretëtira... do të lulëzojë...!” (Is. 35, 1) Po, Shqipëria do të lulëzojë!

Nikolin Sh. Lëmezhi


“Bedri Islami një thesar i kulturës shkodrane”

Nga Farida Ramadani

Shpeshherë kam qenë e pranishme në promovime librash në Shkodër dhe në disa qytete të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Diasporë por është hera e parë që e kam përjetuar aq thellë forcën krijuese të një poeti. Shkrimtari, gazetari, publicisti, kritiku Bedri Islami promovoi dy libra “Vrasja e Lulit të vocërr” (Zeneli babai i Bedriut ishte Luli i vocërr i Migjenit) dhe librin “Vetmi akujsh” në Bibliotekën Marin Barleti e cila atë ditë peshonte shumë rëndë nga vlerat e të pranishmëve tashmë të mirënjohur në të gjitha trevat shqiptare dhe jo vetëm si Maikon Zeqo, Petrit Ruka, Xhevahir Spahiu, Fadil Kraja, Zija Vukaj, Xhahid Bushati, Ekrem Bardhi, Nail Draga etj të cilët kishin një refren të përbashkët “Bedri Islami është poeti i kohës moderne” Mbase Bedriun kam shumë vite që e njoh aq më shumë vëllai im e ka prej vitesh shumë mik.

Se mos ishim vetëm ne të tillë në atë sallë, të gjithë të pranishmit e kishin mik prej kohësh dhe të gjithë gëzonin respekt për të ashtu si dhe unë. Natyra e tij modeste, dashamirëse dhe komunikuese kishte pranuar rreth tij mjaft miq. Dija mjaft për punën dhe aktivitetet e tija por siç duket paskam ditur vetëm majën e ajsbergut pasi veprimtaritë e tij ishin të shumta, voluminoze jo vetëm në fushën e krijimtarisë e të gazetarisë si një informator realist dhe konkret por dhe një lëvruer shumë i mirë në aktivitete kombëtare, kjo ndoshta se prej disa vitesh udhëtimet e tija kanë qenë të shumta.

Krahas shkrimeve me tema të ndryshme në revista, gazeta apo portale të ndryshme kryesisht kontributi i tij ishte mjaft e lavdërueshëm prej vitesh për lirinë dhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë si dhe transmetimin edhe në Amerikë dhe lobimin për këtë çështje dhe për të tjera



çështje në arenën ndërkombëtare. Për këtë më vjen mirë pasi dhe unë mund të kem një pjesë të vogël krenarie se me plot gojë mund të them se jam poetja shkodrane që jam përfaqësuar më shumë në aktivitetet letrare në mbarë shqiptarinë ku dhe jam vlerësuar disa herë. Kam dhe një detyrim personal që më duhet ta shpreh për Bedri Islamin pasi është dhe redaktori i librit tim “Një jetë në 36 shkronja” botimi im i

gjashtë kërkesë që menjëherë ma pranoi.

Salla ku ishim mbledhur për promovimin e dy librave krahas kumtesave të detajuara të shprehura me superlativa për nivelin e tyre u fol për aktivitetet e ndryshme, jetën e tij shtetërore, miqësore dhe familjare. U interpretuan me mjeshtri disa poezi nga aktorët e Teatrit të Shkodrës Agron Dizdari dhe Merita Smaja e cila me poezinë “Ikën djemtë” na bëri

të përlotemi të gjithë por dhe vetë poetin, na preku në një plagë që pothuajse të gjithëve po na rrjedh ashtu si dhe mua. Poezia fliste për dhimbjen e mbarë shoqërisë sonë me ikjen e të rinjve, largimi nga Atdheu, të afërmit, miqtë por dhe nga nënat që shpeshherë nuk arrijnë as të dëgjojnë frymën e fundit të tyre. Do më mbetet në kujtesë një ditë e tillë duke qëndruar me shpresën se Shkodra do të dijë ta vlerësojë për punën disa vjeçare të suksesshme Bedri Islamin. Faleminderit biri i Shkodrës që na bëre krenarë. Përforcove slloganin tonë “Shkodra djepi i kultures. Faleminderit Nënë Dritës dhe Baba Zenelit që të edukuan! Faleminderit që je miku i familjes sonë dhe i gjithë shkodranëve!

Sëmundja e Parkinson-it



Dr. Med. Ndue NIKAJ

Ka marrë këtë emër për nder të kirurgut Anglez James Parkinson, që përshkoi për herë të parë në vitin 1817, si paraliza agjituse, sëmundja kronike (e zgjatur), që prekte në radhë të parë personat 60-70 vjeçar, pra në dekadën e 6-7 të jetës. Sot vlerësohet si sëmundje neuro-degjenerative e sistemit nervor extra-pyramidal dhe klasifikohet në “çrregullimet lëvizore”. Incidenca mesatare e sëmundjes është mesatarisht 20 raste të reja për 100.000 banor në vit, me një kulmim (pik) të saj në moshat 70-75 vjeç, por që në moshën 80 vjeç arrin në 130 raste në vit për 100.000 banor. Në Francë llogariten 150.000 persona të prekur nga Parkinsoni. Llogaritet si sëmundja e dytë neuro-degjenerative, pas sëmundjes Alzheimer. Ajo prek 1% të mbi 60 vjeçarve dhe 4% të mbi 80 vjeçarve. Sido që mekanizmat e sëmundjes së Parkinsonit janë përshkruar mirë, akoma nuk po shërohet. Janë përhapur hipoteza të ndryshme për shkakun (ethio-pathogenezën) e saj/si: virale; gjenetike, toksike ambjentale dhe toksike endogene, të cilat shkaqe shpiejnë (çojnë) në procesin neuro-degjenerativ i cili akoma nuk është saktësuar plotësisht, sido që ka supozime evidente për defekte gjenetike;. Kjo hipotezë mbështetet në të dhëna të rëndësishme si rreth 20% e të sëmurve kanë një patologji të tipit familjar ku është zbuluar gjeni difektuoz. Mendohet se nga defekti në tru grumbullohen proteina toksike, që bllokojnë funksionin e rregullt të qelizave dopaminergjike (pra të qelizave që prodhojnë Dopaminë, lëndë që transmeton impulset ndërmjet neuroneve dhe përfshihet në kontrollin e lëvizjeve). Nga ana strukturale dëmtimet morfologjike kapin zonën qendrore dhe kaudale të pjesës kompakte të substancës NIGRA të Mezencefalit Somering, e cila modifikohet dhe ka një ulje të numrit të neuroneve, me depigmetizim të tyre, prezencë melanine jashtë qelizore dhe shpesh janë të pranishëm dhe trupat Leëis (në 80% të rasteve), nga ambjenti akuzohen disa helme që përdoren në bujqësi, pra akuzohen se dëmtojnë neuronet, por sëmundja shfaqet kur dëmtohen 60-70%

e neuroneve që prodhojnë Dopaminë.

Në studimet e fundit theksohet se sëmundja fillon 70% të rasteve në mënyrë të pa besë (incidioze) dhe paraqitet me dridhje (tremor) të imtë, shpesh të njëanshëm ose asimetrik dhe mbetet e tillë për shumë vitë. Por sot dihet se 15 vjet më parë pacientët mund të kenë çrregullime depresive, konstipacion, ulje të nuhatjes, lodhje intensive, dhimbje muskulare etj.

Shenjat kryesore janë: - Ngurtësimi (Rigiditeti), dridhja fine (tremor) i duarve dhe i kokës, akinezia (çrregullim ecjes) me prishje të posturës (qendrimin) dhe të ekuilibrit, shpesh është i pranishëm depressioni (rreth 60% të rasteve). Ngurtësimi është një shenjë karakteristike dhe konstante dhe që për një kohë të gjatë mbetet i vetmi shenjë i sëmundjes; duhet të theksohet se dy vjet pas çfaqjes së shenjave të para 100% e të sëmurve parkinsonikë janë rigid (të ngurtësuar), megjithatë duhet pranuar se dhe mungesa e rigiditetit nuk përjashton diagnozën. Pra kemi rritje të tonusit muskular ku thenjet e të sëmurit vërtetohen me rezistencën në levizjet pasive, pra e ashtuquajtura hipertonia plastika ose pacienti rendohet si plumb, kjo hipertoni muskulare përqendrohet në muskulaturën aksiale, cervikale, në gjymtyret e sipërme, që shoqërohet dhe me prekjën e muskulaturës distale, me dominim në muskulaturën flexore dhe aduktore duke përcaktuar qëndrimin klasik të Parkinsonikut më kokë e trung pak të përkulur dhe me këmbë në varizum fill-estar.

Ngurtësimi shtohet gjatë lëvizjeve pasive sidomos të kyçit të dorës, të gjurit me mbitonizim të muskulaturës, si një guzhinjetë e dhëmbëzuar.

Dridhja (tremor) – Shfaqet dhe shkaktohet nga tkurrja arithmike e muskulave antagonist, e tipit alternativ me një frekuencë 4-6Hz, zhduket gjatë kryerjes së lëvizjeve të vullnetshme dhe ka tentativë përmirësimi kur pacienti është i qetsuar deri në zhdukje gjatë natës. Ka lokalizim të preferuar në gjymtyrë dhe në veçanti në segmentin distal të gjymtyrve të sipërme, prej ku gishtit i madh (policis) dhe ai tregus bëjnë lëvizje afruse e larguse sikur numron monedha ose lidh cigare duhani. Lëvizje shoqëruese automatike, përvijojnë normalisht në mënyrë të rregullt e harmonike, me ndërhyrje të vullnetshme kompletohen dhe kërkojnë vëmendje e përqendrim. Lëvizjet e vullnetshme janë të reduktume në sasi dhe prishen në gjithë fazat e realizimit të tyre p.sh. lëvizjet përsëritëse të tipit të shpejtë është e alternuar si me bateri rithmike e gishtit të dorës, me ulje-ngritje të ngadalshme të amplitudës. Ecja është e ngadaltë dhe me hap të ngadaltë, me këmbë zvarr (zhag), me lëvizje pendulare të gjymtyrve, të ngadalshme herë para, herë prapa e pa sigurtë. Nisja, fillimi i ecjes është shumë i vështirë aq sa i sëmuri duket si të jetë i lidhur me tokën dhe sidomos kur don të ndryshojë drejtim ose i del një pengesë; në kalimin midis hapsirave të ngushta bllokohet duke konfiguruar fenomenin e akinezis paradoxë (freezing).

Pacienti humb shprehjen normale (mimikën) të fytyrës, e ashtuquajtura fytyrë si “maskë”, e cila është shenjë e herëshme, flitet me një fjalor monoton e të ngadalshëm, pa theks. Ka folje të nxituar e ka të vështirë të diskutojë.

Ka po ashtu prishje e deformim të shkrimit si shenje fillestare, me karakter grafik të pa rregullt, i çrregullt i pa barabartë, që vjen nga dridhja me shkronja gjithnjë e më të vogla duke realizuar të ashtuquajturën e “mikrografi Parkinsonjane”.

Kemi prishje të qëndrimin (posturë) si qëndrim karakteristik i të sëmurit me Parkinson me kokë e shpindë të përkulur para dhe që me kohën përparon në antero-retropulsion dhe me mundësi të rënies për tokë duke u kufizuar në mënyrë ekstreme autonomia e pacientit.

Si shenja të tjera mund të kemi jargimin



(sialorhea) me nxjerrje pështymës anash gojës në fazat e avancuar të sëmundjes, pra nuk arrin të gellitë pështymën e prodhuar me shumicë, po ashtu ka djersë, seborhe e madhe (si krundë në kokë), po ashtu është shumë i lodhur. Në këto të sëmurë preken dhe organe të tjera si ai: cardio-vaskular, gastro-intestinal dhe urinar, për të cilët duhet të kihet vëmendje, për shenjat jo motore.

Për vënjen e diagnozës mbështetemi në bazë tiadës tpikë:

Rigiditet (ngurtësim)

Dridhja (tremor)

Akinezi (çrreg. të ecjes dhe posturës)

si shenja shoqëruese ka ptializëm (jargim), prishje e shprehjes së fytyrës, fytyrë si “maskë” pa mimikë, prishje shkrimi (mikrografia parkinsonjane). Po ashtu mund të ndihmojë Rezonanca Magnetike e trurit (RMN-cerebrale) për të përjashtuar disa sëmundje me shenja të ngjashme; por në mënyrë të veçantë ndihmon Tomografia e kompjuterizuar me fotone (SPECT) dhe PET (Tomografia me pozitron) mund ta plotësojnë diagnozën.

Sot përdoret dhe teknika imazhrike me radio-preparate me ilaçe – DAT- që ka mundësi të konfiguruar kompjuterizimin e sistemit dopaminergjik. Duhet të kemi parasysh se shumë ilaçe japin tremor të ngjashëm me Parkinsonin i ashtuquajturë Parkinsonizëm jatrogen (nga

mjeku), pra disa ilaçe si Rezerpina, Alfa-Methyl-Dopa, flunarizina, Cinarizina japin tremor. Trajtimi duhet të bëhet nga specialisti neuropsyhiater.

Në fazën fillestare kemi ilaçe-antiko-linergjike si Triheksifenidyl, akineton, Biperidon, Orfenadrin etj, si efekte an-sore ka tharje goje-gingivit, kapsllek, retencion urinar, hapje e bebes syrit me prishje akomodimi deri konfuzion mental. Me përparimin e sëmundjes përdorim: Madopar (L-DOPA+benserazide) (200+50)mg sipas këshillës së mjekut, që indukon në shumicën e rasteve një përmirësim të shpejtë dhe domethënës, por sot janë futur dhe Lisuride, Porgolode; frenusit e Katecol – Methyltransferaza (COMPT), po ashtu prej kohësh mund të përdoret dhe Amantadina, që është efektive ne 2/3 e rasteve sidomos e përdorur në kombinim me Madopar.

Kohet e fundit po përdoren metoda te reja me stimulim elektrik te berthamave subkortikale me ane te elektrodave te future ne tru nepermjet nje hapshenesi (pace-macher) te vendosur ne gjoks I cili pranon veprimin e tepert te neuroneve sipas studiuessit Divid Charls dhe ekipit te tij te spitalit Vander Bill (Nazhvil te Tennesit), nga kjo metode perfitojne 25% te te semureve parkinsonik.

Dhe ne se kjo metode perdoret ne fazat epare te semundjes ndihmon vetem lehtesimin e simptomave, por nuk sjell sherim as nuk ndalon evoluimin e semundjes, dhe sipas kesaj ekperience ky perfitim nuk zgjat mbi 5-7 vite, duke ditur se ne bote sot OMS-i (OBSh) njofton se nga parkinsoni vuajne 4 milion vete dhe vetem ne Amerike ka 500000 raste dhe pavaresisht ketyre medotave, krahas ngurtesimit trupor te pengeses se levizjes 20% e ketyre te semureve perfundojne me humbjen e kujteses.

Pra duhet te mos nenvlersohet asnje rast te kapet ne fazat e para dhe te konsultohen me mjekun neuropsikiater dhe mos ndermerrni mjekim sipas keshillave te miqve dhe familjareve.

Pregatiti Dr. Med. Ndue NIKAJ

Zbuloni pesë metalet më të shtrenjta të botës

- Kuriozitete -

Nëse mendoni se ari ose argjendi janë metalet më të shtrenjta në botë, sepse i quajmë “të çmuar”, e keni gabim. Më poshtë po ju sjellim pesë metale që konsiderohen të vlefshme.

Rodiumi

Metal jashtëzakonisht i rrallë, i vlefshëm dhe i argjendte, Rodiumi është metali më i shtrenjtë. Për t’ju pasqyruar rëndësinë e tij po ju themi se një ton e kores së Tokës përmban rreth 0.001g të këtij metali.

Rodiumi ka një pikë të lartë të shkrirjes dhe një aftësi mahnitëse për t’i bërë ballë korrozionit. Metali përdoret zakonisht për vetitë reflektuese në artikuajt si pasqyra dhe bizhuteri. Është i vlefshëm në industrinë e automobilave dhe në disa fusha industriale.



Platinumi

Emri i këtij metali rrjedh nga termi spanjoll platino që do të thotë ‘argjend i vogël’. Është i njohur si një metal i dendur, i epshëm, jo reaktiv dhe jo korrozues. Platinumi është përdorur gjerësisht në bizhuteri për shkak të pamjes të shndritshme dhe rezistencës së shquar.

Gjithashtu përdoret në stomatologji, armatim dhe aeronautikë. Afrika e Jugut, Rusia, Kanadaja dhe vendet e tjera të përpunimit të mineraleve janë ndër prodhuesit më të mëdhenj të metaleve të çmuar.



Ari

Ari është metali më i lehtë i çmuar për t’u njohur për shkak të ngjyrës së tij unike. Mbetet një ndër metalet më të njohura dhe në opsionet e investimit. Është popullor për shkak të ngjyrës, lakueshmërisë dhe përçueshmërisë.

Metali më i njohur në botë përdoret në bizhuteri, elektronikë, mbrojtje nga rrezatimi dhe izolim termik. Burimet kryesore të nxjerrjes së arit janë Afrika e Jugut, Shtetet e Bashkuara, Kina, Australia dhe Rusia.



Ruteni

Ruteni është një nga metalet e grupit të platinumit. Të gjitha metalet e kësaj familjeje konsiderohen si metale të çmuara sepse zakonisht gjenden së bash-



ku në natyrë dhe ndajnë karakteristika të ngjashme.

Karakteristikat e tij përfshijnë fortësinë dhe aftësinë për të përballuar elementët e jashtëm. Ruteni është popullor në fushën e elektronikës si një mënyrë për të kontaktuar në mënyrë efektive kontakte elektrike. Prodhuesit më të mëdhenj përfshijnë Rusinë, Amerikën e Veriut dhe Amerikën e Jugut.

Iridiumi

Një nga metalet më të dendura, Iridiumi është anëtar i grupit të platin. Ai ka një nga pikat më të larta të shkrirjes dhe është elementi më rezistent ndaj korrozionit. Metalet përpunohen nga xehe platin dhe si një nënprodukt i minierave të nikelit. Prodhuesi më i madh i Iridiumit është Afrika e Jugut.

Përdoret në penelët e syrit, bizhuteri, busulla, elektronikë, në mjekësi dhe në industrinë e automobilave. **e.r/dita**



"Jeta ime, në tre kontinente"



harro”, velim me poezi.

Në këtë paraqitje morën pjesë familjar të autorit, intelektual të letrave e fushave të ndryshme dhe deputeti i Qarkut Shkodër, profesor doktor Romeo Gurakuqi. Morën pjesë dhe anëtar të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, si Ndue Sanaj, Luigj Shyti, Gjergj Leqejza, Dukate Bregu, Lazer Kodra, Prele Shytani, Prele Milani (autori i parathënies së librit) dhe Prek Gjonaj.

Këtë ceremoni e drejtoj Përgjegjësi i Muzeut të dëshmisë dhe kujtesës, Pjerin Mirëdita, i cili pasi prezantoi veprimtarinë, i uroi pjesëmarrësve mirëseardhjen, i dha fjalën redaktorit të librit, poetit Lisander Kola. Pastaj ju dha fjala Eduart Grishes, përgjegjësi i librit, në Muzeun Historik të Shkodrës. Fjala ju dha dhe drejtorit të Bibliotekës së qytetit “Marin Barleti”, Gjovalin Çunit. Në fund, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në emër të kryesisë i dorëzoi Ndrek Gurit, titullin “**Mirënjohja Martin Camaj**”, me motivacion:


“Lëvrues i zellshëm i kulturës dhe traditave dukagjinase. Mbështetës dhe promovues i flaktë i dialektit të Gegë. Përmes shkrimeve e librave të Tij shpërfaqet dimensionin human i shpirtit të Njeriut bashkëkohor!”

Kjo veprimtari, u mbyll me një koktej, të shtruar nga autori i librit, me plote bujari, siç e ka pas dhe e ka në traditë, Ndrek Guri.

Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"

Me datën 23 shtator 2018, në mjediset e Muzeut të dëshmisë dhe kujtesës u zhvillua ceremonia e paraqitjes së librit, me titull “Jeta jeme, në tre kontinente”, të autorit Ndrek Dede Guri.

Ndrek Guri, vjen në këtë paraqitje pas katër librave të tjerë, me titull: “Brejtësit e shprese”, vëllim me poezi; “Nji za n’ ander”, vëllim me poezi; “Dom Prek Ndrevasaj”, jete shkrim; “Fal, por mos



poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi ***

UNË E PASHË KU ËSHTË DAFINA

Një zarf me karafila
Në nga nga një i dhurove sot
Plot kujtime sjell rinia
Ah, sa keq, s'kthehet dot!

Unë e pashë ku është Dafina
Sytë e vajzës janë mbush me lotë
Nanës së mjerë i dridhet zemra
Pse kaq randë më denove Zot?

Si Leonida me treqind spartanët
Burrat e Kaçanikut luftojnë
Breshëri plumbash mbi barbarët
Trojet tona gjallë s'i lëshojmë.

Frymëzimin tand pak-kush e ka
Ai peshon sa një mal flori
Ditë e natë të presim vëlla
Na dogji malli, ktheu në shtëpi.

Shpirti yt artist gjithashtu i ndjeshëm
Fllad i ngrohët i mëngjeseve pranverore
Në festivale me penën e fuqishme
Fëmijët e Shqipërisë kurdoherë i gëzove.

TË PRISHEN VRESHTAT

Për t'i hapur rrugë shkatrimëve
Me mijëra i nxorren në asistencë
Ky ishte fillimi i ndryshimëve
Nga e "vjetra" drejt së "resë".

Të prishen vreshtat në çdo anë
Janë të vjetra pa rendiment
Do të mbjellim të tjerë fidanë
Nga Shkodra deri në Përmet...!

Këto sera diellore ç'janë?!
I dini kush i ka ndërtuar?
Të tëra këto më nuk bëjnë
"Made vechia", kanë mbaruar.

Egersisht u zbatu "parimi"
Çdo gjë të shkoj në zero
Pa këtë s'vjen përparimi
Kush punoi, shko, ik, pjer...!

Ç'na duhet centrali në Shkodër?
Të hidhet menjëherë në erë
Do ndërtojmë një tjetër në kodër
Si në Amerikë e Angli tërë.

Me plagë në zemër pret i shkreti
Radhën për një telefonatë
Fëmijët e tij jashtë shtetit
Sonte mbetën pa nanë.

Njëqind copash ajo u ba
Mer një pjesë e hidh një tjetër
Ku e çon tornon o vëlla?
S'asht sharqi dhe as pjepër!

Mbi atë zgërdhien dreqnit
E shpërndahen naltë e poshtë
Fluturojnë në maje të plepit
Duke "kënduar"si kaposh.

TË KUPTOVA, TË LUTEM MJAFT!

Të dëgjova, të lutem boll
Me leksione për të vertetën!
Kur dikur i mbushe plot
Tash na mëson si me lidhë bre...!

Të frikësuan stuhitë
Era e barotit anë e mbanë

Menjëherë, shpejt ke ikë
Ata atje le të vdesin të tanë!

Paskam ra në boshllëk
Një handek qënka kriju
Medet, pak-kush më flet
Spektatori më ka harru!

Ju kam xhan, ju kam shpirt
Gjumi i natës nuk më zen
Jam artiste ekstra e mirë
Në spektakël të la pa mend!

KAFEN TË GJITHË E PINË

Në një lëndinë
Njëqind metër të gjatë
Kafen të gjithë e pinë
Burrat pa gratë!

Fati na ka ardhë
Kështu e ka kjo botë
Sa një bukë e bardhë
Kushton një kafe sot.

Në mëngjes herët
Shkojmë për një kafe
Xhepi ynë"qethët"
Por nuk ban naze!

E ardhmja në dorën tuaj
Urdhëroni, pas verës ujë
Petulla me biftek
E ardhmja në dorën tuaj
Një andërr në dyshek.

Do jem "aksionere"!
E para në Telo Kom!
Për ju iken hallet!
Prandej vieni-come.

Gati, shpejt vraponi
Bonot te mikështa
Kujdes, mos nguroni
E juaja "Mbretnesha"

Nuk të zë gjumi
Diçka s'të funksionon
Kur të preken gjunin
Me të tjerë po shkon!

Do të bëheni me bens
Të pasur milionerë
The future is in your hands!
Kur të jeni duke dhj...

Banka e Kursimit
Për ty një okej
Urdhër xhirimin
E çove në holidëj!

I MJERI I NANËS

Oh, shpirti i nanës!
E mjera unë për ty
Te Shtegu i Thanës
Të vrau përbindëshi i zi!

Janë nguju fëmia
Nuk shkojnë në shkollë
Tmeri e mërzia
E ka ba si shollë.

Në sy të fëmijëve
Të gruas shtatzanë
Plumbi në mes të brinjëve
Në vend e ka lanë.

Mos e prek këtë fëmi
Turpi të mbuloft
Ti nuk je njeri
Je stervinë e coft.

TA MARSHA TENDËR

Dy krisma i lëshoj
I shpëtuan pa dashje
Oh, sa keq, gaboj!
Iu skuqen faqet.

Ishte biondinë
Me za melodioz
Në shpirt i ka hi
Në mish e në kockë.

Kushtrim mblidhuni
Bani gati letrat
Fiton më i miri
Në radhë të parë kuleta.

Një gjethe mendër
Sa e mirë kjo erë
Ta marsha tender
U bana milioner!

AMANETI I FUNDIT

Amaneti i fundit
I Heroit Kombëtar
Do na marë lumi
Veç e veç të ndarë.

Besën mbrojeni
Asht forca e jonë
Kombin naltësoni
Dhe Atdheun tonë.

Me vëllaznit e vet
Kush përdor hile
Ai asht agrep
Një mi apo skile.

Hapeni zemrën
Zhdukni zilitë
Kush mbjell erën
Do të korrë stuhitë.

LULE NËN NJË SHKËMB

At ditë kur të pashë
Plot lulëzim nën një shkëmb
Menjëherë me vehte thashë:
Mrekulli qënke tamam!

O e bukura ngjyra ylberi
Me rrenjë nën një shkëmb
Ty të mora në breg të liqenit
Një merak të madh kam!

Të hoqa nga vendi me kujdes
Tan trupin tand e preka
Ishe e njomë si uji e vesa
Para tejet i mahnitur mbeta!

Të shikoj e të marë erë
Për zemrën time je simbol
Shoqet tuaja në pranverë
Nga malli derdhin lotë.

Çdo vit ato lulëzojnë
Një ditë era i tretë së largu
Njeri tjetrin e kujtojmë
Shpesh rrijmë së bashku.

Luigj Temali

FALEMINDERIT TË GJITHËVE



Zgjedhjet për strukturat drejtuese të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" përfunduan me sukses të plotë. Ishte një manifestim pjekurie dhe serioziteti në të gjithë elementët e tyre. Drejtuesve të zgjedhur dhe të rizgjedhur ju uroj suksese në çarjen përpara të gjithë veprimtarisë së tyre në shërbim të shoqatës dhe komunitetit dukagjinasi kudo që ndodhet.

Në këto ditë zgjedhjesh të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", por edhe që prej gati 6 muajsh, kam marrë shumë mesazhe, me janë bërë shumë pyetje, kam pasur shumë biseda kokë më kokë, nga miq e dashamirë, e nga drejtuesit e shoqatës, anëtarë, veprimtarë e dashamirë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe të Dukagjinit e dukagjinasi, dhe më janë shfaqur jo pak propozime, mendime, por edhe shumë "pse" në lidhje me mos pranimin, nga ana ime, për tu zgjedhur në organet drejtuese të kësaj shoqate.

Koha bën të vetën dhe ne njerëzit duhet ta pranojmë. Por njeriu duhet të përpiqet që ta përdorë, që të mos shkojë koha kot, që sa më shumë të marrim prej saj pa e shpërdoruar atë.

Kemi përballuar me sportivitet debatet me njëri tjetrin, ndonjë herë edhe të forta, apo rreptësinë e kryetarit, sepse kishim një objektiv më të rëndësishëm se sa hatërmbetjet personale e të çastit, të cilat vinin edhe si rezultat i vështirësive e pengesave objektive apo subjektive, që na dilnin në realizimin e objektivave tona. Të gjitha ishin për të mirën e punës. Objektivat tonë lidheshin se pari me Dukagjinit dhe malësorët e kësaj krahine. Ne e dinim dhe e dimë se Dukagjini jeton sepse jeton Shqipëria. Por ka pasur, mbase edhe ka, mendime për "fitore në tavolinë" por u përpoqëm e i kaluam së bashku, duke marrë përsipër dhe realizuar detyra që ti shërbejnë këtij komuniteti, për të ndriçuar sa më shumë kohën në të cilën jetonte dhe jeton, për të qetësuar nervat e çastit, kthjelluar mendjen, e përparuar drejt një

të ardhmeje më të mirë. Do të ishte në të mirë të punës që të rinjtë ti kenë para sysh këto në punën e tyre me shoqatën, sepse vetëm kështu do të realizohen detyrat e ditës dhe objektivat themelor të saj.

Kanë kaluar 15 vjet që shoqata

për të qenë sa më i plotë dhe i zbatueshëm më mirë. Arritjet janë vepër e të gjithë kryesisë dhe anëtarëve të shoqatës.

Prej dhimbjeve kemi ardhur në jetë dhe nga dhimbjet do të largohemi prej saj. Por ka dhimbje e dhimbje. Ka nga ato

hapësire mjaft të gjerë. Askush nuk është i pazëvendësueshëm, askush nuk është i përhershëm, por, secili duhet të vejë një "gurë" si pengesë për të mos vdekur sapa të varrosët. Shoqata jonë dhe të gjitha ata që janë përfshirë në punën e saj, tashmë e kanë vendosur një pengesë mjaft të mirë në rrugën e harrësës, dhe kjo nuk është pak. Të gjithë u përfshimë në veprimtari shumë të rëndësishme, që përmbledhtas mund të shprehet me pak fjalë, **"vlerësim për të kaluarën, kujdes për të sotmen, mesazhe për të ardhmen"**. Kjo, mendoj unë, nuk është pak, e që kam besim se do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Mbase mund të jenë si një synim, si një devizë, në objektivat e shoqatës edhe në vazhdim.

Puna në shoqatë, duhet thënë dhe pranuar, se na ka ndihmuar, na ka rritur dhe jemi rritur bashkë me shoqatën, na ka bërë më të mirë, na ka dhënë emër më të mirë, na ka bërë më të fuqishëm në mend dhe pendë, në komunikim dhe bashkëpunim. Të gjithë kemi marrë shumë emër duke punuar në shoqatën tonë, madje më shumë se nga detyrat funksionale dhe punët për të cilat jemi paguar ose paguhemi aktualisht. Vullnetarizmi, vlerësimi serioz i punës, duarlarg nga vlerat monetare, na kanë bërë më të fuqishëm në arritjen e objektivave të shoqatës, më të aftë dhe më të fuqishëm në përballimin e debateve e kundërshtive, si brenda Kryesisë, Këshillit apo Shoqatës tonë, por edhe në marrëdhënie me të tjerët.

Do të vazhdoj të jem gjithnjë pranë kolegëve të mijë, pranë Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" e Kryesisë së saj, në të gjitha rastet e nevojshme e të mundura, pranë gazetës "Dukagjini" që për mua ka qenë dhe mbetet shumë e dashur, e në të cilën besoj se do të kem hapësirën e bashkëpunimit, pranë Dukagjinit dhe dukagjinasi, por edhe pranë dashamirëve të mijë të kudo ndodhur, me gjithë mundësitë e mija mendore dhe fizike. Faleminderit të gjithëve për respektin, ndihmën dhe mbështetjen, në punën time me shoqatën i cili u manifestua edhe kohët dhe ditët e fundit nga gjithë të interesuarit për mua dhe punën time.

Gjithmonë me shumë respekt për të gjithë.

Luigj SHYTI, tetor 2018

DEKLARATË

Drejtuar Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" Kryetarit Zotit Ndue Sanaj

Zonja/zonjushë dhe zotërinj të nderuar!

Jam ndjerë mirë me punën që kemi bërë gjatë këtyre 15 viteve në shoqatën tonë. Jam përpjekur që të jem në lartësinë e duhur gjatë gjithë punës, jo vetëm për të zbatuar detyrat që më janë ngarkuar, por jam përpjekur edhe me mendime në të mirë të punës dhe rezultateve të kësaj shoqate, e cila ka hyre dhe me siguri do të mbetet në historinë e Dukagjinit, Shkodrës dhe më gjerë.

Jam përpjekur dhe mendoj se ja kam arritur që të jem në vendin dhe kohën e duhur me ide, fjalë e veprime, në shërbim të punës së shoqatës dhe shoqërisë.

Së bashku kemi arritur atë që nuk e kemi parë në asnjë shoqatë, në asnjë kohë, për Dukagjinit, por edhe më gjerë.

Unë ndjehem i plotësuar, siç e kam thënë edhe më parë, për punën, arritjet dhe bashkëpunimin në kryesinë e shoqatës e midis kolegësh.

Dua të falënderoj shumë ngrrohtësisht të gjithë anëtarët e kryesisë për vlerësimet ndaj meje, për besimin, për respektin. Falënderimi është, po mëdyshje, edhe për gjithë anëtarët e shoqatës. Kemi diskutuar, madje edhe të tensionuar ndonjë herë, por duke qenë se e kishim për të njëjtin qëllim dhe të mirën e punës, kemi arritur në mirëkuptim dhe realizuar objektivat, të gjithë bashkë.

Dua të falënderoj shokun tim, kryetarin tonë Ndue Sanaj, me të cilin kishim pak njohje, e vinim nga fusha të ndryshme të jetës, që ndryshonin nga njëra tjetra, por na bashkoi dashuria për Dukagjinit dhe dukagjinasi në të gjithë komponentët e saj.

Duke qenë se janë realizuar objektivat e mija nëpërmes punës së përbashkët, unë kam vendosur që të hap krahun, të largohem nga strukturat drejtuese të shoqatës, tu krijoj mundësi atyre që kanë ide të reja, që janë më të rinj në moshë e në mendime dhe që kanë energji e dëshirojnë për punë të mëtejshme me shoqatën.

Në zgjedhjet e ardhshme nuk do jem më pjesë e kryesisë së kësaj shoqate.

Do të përpiqem të jem, si edhe deri tash, një dukagjinasi sa më i mirë bashkëkohor, në qëndrime, punë e mendime.

Do të vazhdoj të punoj për Dukagjinit dhe vlerat e tij.

Deri në zgjedhjet e reja do të jem në të njëjtin nivel angazhimi pranë shoqatës si edhe deri tash.

Ju përshëndes të gjithëve me shumë respekt dhe ngrrohtësi.

Uroj më të mirën për të gjithë ju, dhe për Shoqatën Atdhetare "Dukagjini".

Me respekt për të gjithë.

Shkodër, më 14.5.2018

Luigj Shyti

jonë është ligjësuar por puna, për disa nga kryesia, ka filluar të paktën gati një vit më parë. Ndjehem mirë që isha njëri nga nismëtarët për formimin e kësaj shoqate. Por ndjehem mirë edhe për faktin sa nga dëshira për të bërë sa më shumë për Dukagjinit, vura me shumë dëshirë, mendjen në punë, aq sa kisha, se çfarë mund dhe duhet të bëjmë për vendlindjen tonë të dashur, Dukagjinit. Ndjehem mirë se idetë gjetën mbështetjen e duhur, sepse kjo ka qenë e zakonshme në shoqatën tonë, që çdo mendim a propozim është diskutuar thellë, është pasuruar e pastruar,

që është më mirë ti përjetosh, sepse kujtimet do të shoqërojnë gjithmonë. Një nga dashuritë e mija shumë të fuqishme është Shoqata Atdhetare "Dukagjini" dhe gazeta e saj "Dukagjini". Unë largohem nga kjo dashuri me dhimbje, por më mirë kështu.

E quaj të realizuar objektivin tim për këtë periudhë, së cilës ju përkushtova shumë seriozisht me të gjitha mundësitë e mija, e duhet thënë se pata edhe hapësirën e nevojshme nga Kryetari, kryesia, shoqata, nga bashkëkrahinarët e mijë, po edhe nga shokë, miq e dashamirë të një

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

**GËZIM KOLË
ÇARDAKU**

